



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujo - Mars 2008

Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës seriozisht ndikojnë në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut

I. Situata në Mitrovicë/Mitrovica

A. Sfond

Deklarimi i pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 solli trazira në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica. Situata ndikon rëndë në funksionimin e gjykatave të regjionit duke qar kështu në shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Këto ndërlihen me të drejtën për qasje në drejtësi, të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme, të drejtën për liri dhe të drejtën për gjykatë të themeluar sipas ligjit.

Reagimet e disa serbëve të Kosovës në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica kundër deklaramit të pavarësisë kanë ndikuar kryesisht në katër gjykata: Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Gjykatën Komunale në Leposavić/Leposaviq, dhe Gjykatën Komunale në Zubin Potok. Gjithashtu pati ndikim në tri gjykata për kundërvajtje në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica si dhe zyrat e prokurorisë së qarkut dhe ato komunale.

Sa i përket institucioneve me seli në kompleksin e gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica,¹ asnjë nga ato nuk ka funksionuar që prej 20 shkurtit 2008. Duke filluar nga 21 shkurti 2008, një grup prej 50 deri 200 protestuesve, në mes tyre edhe punëtorë të sistemit të drejtësisë para vitit 1999 u mblodhën jashtë kompleksit të gjykatës në mëngjeset e ditëve të punës përfaqësisht për tri orë duke kërkuar të hyjnë në ndërtesë dhe ta kthejnë atë në sistem gjyqësor të Serbisë. Policia ndërkombëtare e siguroi ndërtesën e gjykatës duke mos i lejuar qasje askujt derisa protestuesit me dhunë hynë në ndërtesë me 14 mars 2008. Me 17 mars 2008, në një operacion të përkrahur nga KFOR-i, policia e UNMIK-ut hyri në ndërtesë dhe i arrestoi uzurpuesit. Pasuan trazira qytetare serioze.

Deri më sot, as prokuroritë e as gjykatat nuk kanë qenë në mundësi ta rifillojnë punën e tyre.² Për shkak të tensioneve të vazhdueshme politike, është e paqartë se a do të mund ta bëjnë ato një gjë të tillë në një të ardhme të afërt.³

Sa i përket komunave tjera veriore, me 22 shkurt 2008 Ministria e Drejtësisë së Serbisë aneksoi gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok. Stafit i këtyre gjykatave të UNMIK-ut u transferua në sistemin e drejtësisë së Serbisë dhe iu bashkua stafit të gjykatave paralele. Plani i Ministrisë së

¹ Gjykata e Qarkut, Gjykata Komunale dhe Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica.

² Gjykimet penale kanë vazhduar vetëm në Gjykatat Komunale në Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica. Megjithatë, prokurorët ballafaqohen me mjaft vështirësi pasi që ata nuk kanë qasje në dokumentet dhe dëshmitë e tyre prokuroriale por duhen të mbështeten në dosjet e gjykatës.

³ Me 25 mars 2008, Kryetari i Gjykatës së Qarkut në the Mitrovicë/Mitrovica i dërgoi një letër zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, komandantit të KFOR-it, komisarit të policisë së UNMIK-ut dhe kryesuesit të Departamentit të Drejtësisë, duke kërkuar siguri të mjaftueshme që do t'i lejonte gjykatat t'i rifillojnë funksionet e tyre në kompleksin në veri.

Drejtësisë së Serbisë për të shqyrtuar lëndët e gjykatave të UNMIK-ut nuk është i qartë.

B. Shqetësimet lidhur me të drejtat e njeriut

1) E drejta për qasje në drejtësi. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se “çdokush [ka] të drejtë që ta sjell pranë gjykatës ose tribunalit çfarëdo kërkesë që ka të bëjë me të drejtat dhe obligimet e veta qytetare,”⁴ dhe që “pengesa, madje edhe ajo e karakterit të përkohshëm, mund të bie në kundërshtim me Konventën.”⁵

Që nga 20 shkurti 2008 askush (as gjyqtarët, prokurorët, punëtorët e gjykatës e as palët) nuk kanë pasur mundësi të kenë qasje fizike në gjykatat në Mitrovicë/Mitrovica. Kështu banorët e Mitrovicës/Mitrovica nuk kanë qasje në mjetet juridike në rastet penale (për shembull, ata nuk mund të parashtrajnë ankesa kundër vendimeve dhe aktgjytimeve) dhe në rastet civile (ata nuk mund të parashtrajnë kurrfarë padie apo kërkesë). Veç kësaj, është ligjshmërisht e paqartë se a vazhdojnë të kalkulohen afatet ligjore për palë për derisa gjykatat nuk janë në funksion.

2) E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdo kush ka të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme.⁶ Në një rast gjykata ka gjetur se “trazira publike” në regjionin ku është mbajtur gjykimi ishte marrë si arsytim i vlefshëm për vonesa në procedurë⁷ por vetëm për aq kohë sa autoritetet publike të ndërmarrin masa për t’i transferuar lëndët tek një juridiksion tjetër territorial. Në fakt autoritetet publike kanë për detyrë t’i organizojnë sistemet e tyre juridike në atë mënyrë që t’i lejojnë gjykatat të veprojnë në pajtim me parimin e “kohës së arsyeshme”.⁸

Pasi që gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatës së qarkut dhe asaj komunale nuk kanë pasur mundësi të hyjnë në zyrat e tyre që prej 20 shkurtit 2008, asnjë gjykim penal nuk është mbajtur në tërë regjionin dhe asnjë gjykim civil nuk është mbajtur pranë Gjykatë Komunale në Mitrovicë/Mitrovica. Pezullimi i aktiviteteve të gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica në mënyrë të paevitueshme qon në vonesa të procedurës penale dhe civile duke pasuar me shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.⁹ Kjo është veçanërisht shqetësuese në rastet ku nevojitet urgjenca

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, paragrafi 36.

⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Palaoro kundër Austrisë*, aktgjykimi 16718/90, 23 tetor 1995, paragrafi 41.

⁶ Neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁷ *Shih* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Foti kundër Italisë*, aktgjykimet 7604/76, 7719/76, 7781/77 dhe 7913/77, 10 dhjetor 1982, paragrafi 61.

⁸ *Shih* p. Sh. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Eckle kundër Gjermanisë*, aktgjykimi 8130/78, 15 korrik 1982, paragrafi 92. Në *Milasi kundër Italisë*, për më tepër Gjykata gjeti se “grumbullimi i përkohshëm i punës nuk hedh përgjegjësi në Shtetet Kontraktuese në qoftë se ato kanë ndërmarr me shpejtësi të duhur veprime korrigjuese për të trajtuar situatën e jashtëzakonshme” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Milasi kundër Italisë*, aktgjykimi 10527/83, 25 qershor 1987, paragrafi 18).

⁹ Këto vonesa gjithashtu ndikojnë edhe në gjykatat për kundërvajtje. Veçanërisht shqetësuese është se, personat të cilëve u janë konfiskuar përkohësisht patentë-shoferët ose pasaportat për të siguruar pagesën e gjobës nuk kanë mundësi t’i rimarrin dokumentet e tyre. Edhe në qoftë se ata kanë dashur ta paguajnë gjobën, nuk kanë mundur ta bëjnë këtë, pasi që nuk kanë qasje në gjykatë. Gjyqtarët për kundërvajtje nuk kanë qasje në gjykatën e tyre dhe kështu nuk kanë mundur të ua kthejnë këto dokumente pronarëve të tyre ligjor. Në fakt, disa persona të cilët kishin ardhur nga shtetet e jashtme për

speciale, siç janë kërkesat për urdhra mbrojtës në rastet e dhunës familjare ose rastet penale kundër të dyshuarve që ndodhen në paraburgim.¹⁰

3) E drejta për liri. Ligji i Kosovës parasheh afate kohore për paraburgim, afat që fillimisht duhet të konfirmohet¹¹ e më pas periodikisht të rishqyrtohet nga ana e gjykatës kompetente.¹² Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të justifikohet vazhdimi i paraburgimit ndaj të dyshuarit, autoritetet publike jo vetëm që duhet të dëshmojnë se bazat për këtë gjë vazhdojnë të ekzistojnë por gjithashtu duhet të aplikojnë “vëmendje të veçantë” gjatë rrjedhës së procedurës.¹³ Në të kundërtën, paraburgimi bëhet i kundërligjshëm,¹⁴ dhe personi duhet të lirohet në pritje të gjykimit.¹⁵

Prej 20 deri 27 shkurt 2008 Gjykata e Qarkut dhe Komunale në Mitrovicë/Mitrovica nuk kanë mundur ta shqyrtojnë asnjë rast që ka të bëjë me paraburgim. OSBE-ja ka informatë se së paku dy të dyshuar ishin liruar nga qendrat e paraburgimit për shkak se vendimet për paraburgim të tyre kishin skaduar.¹⁶

OSBE-ja mirëpret atë se, që nga 27 shkurt 2008, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale në Mitrovicë/Mitrovica kanë zhvilluar seanca dëgjimore për paraburgim¹⁷ duke shfrytëzuar objektin e Gjykatës Komunalë në Vushtrri/Vučitrn.¹⁸ Megjithatë, OSBE nënvizon se kjo zgjidhje e përkohshme mund të mos jetë e mjaftueshme për të shmangur shkeljet e të drejtave të personit në paraburgim.¹⁹ Në fakt, autoritetet publike duhet të sigurojnë që paraburgimi i personit nuk do të vazhdojë më shumë se sa është e nevojshme.²⁰ Si shtesë ndaj këtij obligimi, autoritetet duhet të ndërmarrin hapa pozitiv për të ri-organizuar sistemet e tyre në atë mënyrë që procedurat (përfshirë këtu edhe hetimet) të zhvillohen pa zvarritje të panevojshme.²¹ Brengosëse është se, OSBE-ja tashmë ka monitoruar së paku një rast ku Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica *inter alia* kishte vazhduar paraburgimin ndaj një të pandehuri

të festuar deklarimin e pavarësisë së Kosovës, dhe të cilëve u ishin konfiskuar pasaportat, janë në pamundësi të kthehen në vendet e tyre të banimit.

¹⁰ Ligji vendor parasheh që gjykatat duhet të veprojnë me urgjencë të veçantë kur i dyshuari mbahet në paraburgim (shih nenin 463(4), Kodi i Procedurës Penale).

¹¹ Neni 212(4), Kodi i Procedurës Penale.

¹² Neni 284 dhe më tej, Kodi i Procedurës Penale.

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Dobrev kundër. Bullgarisë*, aktgjykimi 55389/00, 10 gusht 2006, paragrafi 79.

¹⁴ Shih nenin 5(1)(c), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁵ Shih nenin 5(3), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁶ Intervista e OSBE-së me një avokat mbrojtës, 20 mars 2008. Dy të paraburgosurit, të dyshuar për rrëmbim (neni 159(1), Kodi Penal) ishin liruar me 22 shkurt 2008.

¹⁷ Kjo përshin dëgjimin brenda 72 orëve si dhe seancën dëgjimore për të vendosur mbi vazhdim të paraburgimit.

¹⁸ OSBE është gjithashtu në dijeni se, në mënyrë që të shmanget lirimi i personave të cilët aktualisht gjenden në paraburgim, disa gjyqtarë nga Mitrovicë/Mitrovica zhvilluan seanca dëgjimore në qendrën e paraburgimit në Lipjan/Lipljane.

¹⁹ Veç kësaj, ky solucion ngrit pyetje rreth qasjes së serbëve të Kosovës (përfshirë edhe avokatët mbrojtës) në këtë gjykatë, pasi që ata mund të mos jenë në gjendje ose të mos dëshirojnë të udhëtojnë lirë në atë gjykatë.

²⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se “paraburgimi i vazhduar mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka indikacione specifike të kërkesës së vërtetë lidhur me interesin e publikut, përkundër supozimit të pafajësisë, mbizotëron rregullin për respektimit të lirisë së individit” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Labita kundër Italisë*, aktgjykimi 26772/95, 6 prill 2000, paragrafi 152).

²¹ *Ibid*, paragrafi 2.

sepse prokurori, për shkak të situatës aktuale nuk kishte mundësi t'i vazhdojë hetimet kundër të dyshuarit.²²

4) E drejta për gjykatë të themeluar sipas ligjit. Gjykatat tjera, përpos atyre të UNMIK-ut në Kosovë, janë kundër-ligjore.²³ Themelimi i gjykatave serbe në disa komuna veriore është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-ve, Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1,²⁴ dhe Kornizën Kushtetuese.²⁵

Veç kësaj, hyrja në funksion e gjykatave të tilla ngrit dyshime sa i përket pajtueshmërisë me kërkesën nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut për “tribunal të themeluar sipas ligjit”.²⁶ Sipas Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, “çdo kush do të ketë të drejtën për t’u gjykuar nga gjykatat e rregullta ose tribunalet që përdorin procedurat e themeluara ligjore.”²⁷ E drejta për dëgjim para gjykatës kompetente kërkon që asaj gjykate të i është dhënë me ligj kjo e drejtë. Në kundërshtim, gjykatat e mëparshme legale të UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok të cilat me 22 shkurt 2008 ishin aneksuar nga Ministria e Drejtësisë së Serbisë, nuk operojnë më në bazë të ligjit të zbatueshëm në Kosovë dhe kështu ato janë kundër-ligjore.

Së fundi, funksionimi i gjykatave tjera nga ato të UNMIK-ut krijon pasiguri ligjore. Nëse gjykatat e tilla do të lëshojnë aktvendime penale, kjo mund të paraqet shkelje të parimit të ligjshmërisë²⁸ (pasi që këto gjykata mund t’i dënojnë kryesisht e veprës duke u bazuar në ligjin i cili nuk është i zbatueshëm në Kosovë) dhe mbase të lëshojnë vendime penale kontradiktore dhe/ose shkelje të parimit *ne bis in idem*.²⁹ Për më tepër, gjykatat paralele mund të qojnë në çështje gjyqësore të dyfishta, zgjedhje të juridiksionit të gjykatës, dhe vendime kontradiktore në rastet civile.

II. Situata e sistemit të drejtësisë në regjionet tjera

Deklarimi i pavarësisë me 17 shkurt gjithashtu ndikoi edhe në disa gjykata jashtë regjionit të Mitrovicës/Mitrovica.

²² Me 12 mars 2008, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica vazhdoi paraburgimin kundër një të pandehuri të dyshuar për rate të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes (neni 256(1), Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, të 6 korrikut 2003), dhe grabitje (neni 255(1), Kodi Penal). Në mes të arsyeve për vazhdim të paraburgimit, gjykata morri parasysh faktin se nuk ishte e mundur të dëgjoheshin disa dëshmitarë, pasi që “prej 17 shkurtit 2008 puna në Prokurorinë e Qarkut nuk mund të zhvillohet në mënyrë të rregullt”.

²³ Shih Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *Strukturat Paralele në Kosovë*, tetor 2006.

²⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1, *Për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë*, 25 korrik 1999.

²⁵ Shih nenin 9(4) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9, *Mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë*, 15 maj 2001.

²⁶ Neni 6(1) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁷ Parimi 5, Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, i adoptuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave, të mbajtur në Milano prej 26 gusht deri 6 shtator 1985 dhe të miratuar nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985, i cili kushtëzon se “gjykatat të cilat nuk përdorin procedurat e duhura të përcaktuara të procesin ligjor nuk do të krijohen për të zhvendosur juridiksionin që i takon gjykatave të rregullta ose tribunaleve gjyqësore.”

²⁸ Neni 2, Kodi Penal.

²⁹ Shih nenin 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe nenin 14(7) të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Në Gjykatën Komunale në Prishtinë/Priština, dy gjyqtarët serb të Kosovës nuk kanë shkuar në punë për një javë pas 17 shkurtit 2008. Ata rifilluan punën e tyre prej 25 shkurtit 2008. Dega e Gjykatës Komunale së Prishtinës/Priština në Gračanica/Graçanicë nuk ka punuar prej 18 deri me 22 shkurt 2008 dhe rifilloi funksionet e saj të rregullta me 25 shkurt 2008. Në Gjykatën Komunale në Lipjan/Lipljane dy gjyqtarët porotë, serb të Kosovës nuk kanë punuar pas 18 shkurtit 2008. Ngjashëm, në Gjykatë e Qarkut dhe Gjykatën Komunale në Gjilan/Gnjilane dy gjyqtarët serb të Kosovës dhe një prokuror serb i Kosovës nuk u paraqiten në punë që prej 18 shkurtit 2008. Dega e Gjykatës Komunale së Ferizajt/Uroševac në Štrpce/Shtërpçë ka mbajtur vetëm gjykime urgjente që prej 18 shkurtit 2008.³⁰

OSBE është e brengosur se situata në Gjilan/Gnjilane dhe Štrpce/Shtërpçë mund të shkaktojë vonesa të panevojshme në procedurat gjyqësore. Për shembull, dy raste pronësore të caktuara për 7 dhe 10 mars 2008 që i ishin caktuar gjyqtarit serb të Kosovës në Gjykatën Komunale në Gjilan/Gnjilane janë shtyrë për datë të pacaktuar, për shkak të mungesës së gjyqtarit.³¹ Një shqetësim i veçantë janë rastet të cilat përfshijnë kërkesa për masa të përkohshme.³²

OSBE është gjithashtu në dijeni se disa punëtorë serb të Kosovës në disa zyra ndërlidhëse të gjykatave (duke përfshirë ato në Gračanica/Graçanicë, Velika Hoča/Hoča e Madhe, Novobërdë/Novo Brdo, Vërbovc/Verbovac, dhe Shillovë/Šilovo) ndaluan së punuari pas 17 shkurtit 2008. Si pasojë, zyrat ndaluan punën e tyre. Kjo pengon qasjen e serbëve të Kosovës në drejtësi, pasi që funksioni i zyrave ndërlidhëse të gjykatave është të ua lehtësojë qasjen fizike në gjykata për anëtarët e komuniteteve jo-shqiptare.

III. Konkluzion

Në përmbledhje, marrja ose mos-funksionimi i gjykatave të UNMIK-ut në Mitrovicën/Mitrovica veriore dhe në pjesët tjera të Kosovës pas deklarimit të pavarësisë në Kosovë, ka pasur pasoja serioze në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Kjo ka quar në shkelje të të drejtave të njeriut siç janë ato në lidhje me të drejtën për gjykatë të themeluar sipas ligjit, gjykim brenda kohës së arsyeshme, liri dhe qasje në drejtësi.

³⁰ Për shënim, të gjithë gjyqtarët në këtë gjykatë janë shqiptarë të Kosovës.

³¹ Në dy rastet tjera pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, të caktuara për gjyqtarin serb të Kosovës, seancat i zhvilloi kryetari për shkak se ai nuk kishte raste tjera të caktuara për atë kohë.

³² Për shembull, në një rast alimentacioni që i ishte caktuar një gjyqtari serb të Kosovës në Gjykatën Komunale në Gjilan/Gnjilane, paditësi kishte kërkuar caktimin e masave të përkohshme me 10 shkurt 2008. Deri më sot, gjykata nuk e ka trajtuar këtë rast.